



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 3399/1 Prot.

Tiranë, më 18.3/2019

URDHËR

Nr. 96, Datë 18.3 2019

**“PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE VJETORE TË DISA STANDARDEVE  
NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE STANDARDEVE  
NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 19 “Përfitimet e punonjësve”, të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 9 “Instrumentet Financiare”, të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta”, të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 17 “Kontratat e sigurimit”, Komenteve dhe Interpretimeve të Raportimit Financiar nr. 23 “Paqartësi mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat” si dhe materialin e veçantë të emërtuar “Përmirësimet vjetore 2015-2017”.
2. Të gjitha standardet e mësipërme, përveç Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 17, do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas datës 01.01.2019.
3. Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar nr. 17 “Kontratat e sigurimit” do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël që fillon më ose pas datës 01.01.2021.
4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTËR

Anifa Denaj

